



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SELENICË
NJËSIA E PROKURIMIT

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNE

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: *“Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet të varfëra dhe të pa favorizuara”.*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

VLERA E FONDIT LIMIT: 51,815,285 (pesëdhjet e një milion e tetëqind e pesëmbëdhjet mijë e dyqind e tetëdhjet e pesë) **lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, **Bashkia Selenice** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Argumentimi : Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe VKM Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit përcaktohet se në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Në përfundim të punës grupi u referua në nenin 76 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, pika

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve bazuar në pikën 2, neni 19 i VKM – së Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të

integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, hartues të projekt – preventivit rezultoi vlera e përgjithshme e kontratës.

Afati i realizimit të punimeve është 6 (gjashtë) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kriteri (a) është vendosur ne baze te nenit 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kriteri (b) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

1.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar si dhe në ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 ”Për Qendrën Kombëtare të biznesit”, të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet te paraqesin vertetim per xhiron vjetore per vitet financiare **2021, 2022** dhe **2023**, ku vlera e xhiros per 3 (tre) vitet e fundit duhet te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit te kontrates qe prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 shkronja c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përbushur me sukses kontratën

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet te paraqesin bilancet vjetore, per vitet financiare **2021, 2022**, dhe **2023**, te shoqeruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetem ne rastin kur jane ne kushtet e percaktimeve te *ligjit Nr.10 091, date 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteteve te njepasnjeshme, nuk duhet te kene raport negativ ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 43, pika 4 te VKM-së Nr.285 datë 05.03.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar , si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ligjin nr.10091”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. i cili parashikon se: “Personat juridikë që detyrohen për

auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha **detyrimet e taksave dhe tarifave vendore**, lëshuar nga Pushteti Vendor, **për vitin 2023 – 2024 ne te gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitetin** referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument ne momentin e dorezimit te dokumentave).

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i ka shlyer detyrimet e taksave dhe të tarifave vendore për vitin 2023, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues perpara lidhjes se kontrates.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar sipas të cilit operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore, në Ligjin Nr. 9 920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin Nr. 131/2015 "Për QKB" i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr. 9 723, datë 03.05.2007 "Për QKR", i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.1.1 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vleres se përlloritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme duhet të paraqiten:

- **Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:**

- a) Kontraten e Spermarrjes,
- b) Situacionin perfundimtar te objektit
- c) Fatura Tatimore
- d) Aktin e Kolaudimit te objektit
- e) Formular Vleresimi nga Investitori sipas shtojces nr. 9
- f) Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar të punimeve.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- **Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:**

- a) Kontraten e Siper marrjes,
- b) Situacionin perfundimtar te objektit
- c) Faturat Tatimore
- d) Aktin e Kolaudimit te objektit

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;
- Per kontratat e realizuara si Nenktraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratë baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.

Formular vlerësimi

Situacion Përfundimtar & Faturat Tatimore

Pika a) *plotësohet nga anetari i cili ka përqindjen me te madhe te pjesemarrjes ne bashkim. Anetaret e tjere te bashkimit do te paraqesin kontratat e ngjashme ne raport me përqindjen e pjesemarrjes se tyre ne bashkim. Kurse pika b) duhet te plotësohet nga te gjithë anetaret e bashkimit ne raport me përqindjen e pjesemarrjes se tyre ne bashkim.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogel se dyfishi i vlerës limit të objektit te prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit te operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

• **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**

- Kategoria NP-1 – Punime gërmimi në tokë – Klasifikimi A
- Kategoria NP-3–Rikonstruksion dhe mirëmbajtje gadinash civile e industriale, veshje fasada – Klasifikimi B

• **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**

- Kategoria NS-1 – Punime për prishjen e ndërtimeve – Klasifikimi A
- Kategoria NS-4 – Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me matëriale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese – Klasifikimi A
- Kategoria NS-8 c. – Struktura Druri – Klasifikimi A
- Kategoria NS-14 – Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj – Klasifikimi A

* *Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i liçensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Liçensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Liçensa Profesionale.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4).

* *Per Operatoret e huaj te behet njehesimi i licenses profesionale qe disponojne nga vendi i origjines prane Ministrise se Puneve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit ne plotesimin e liçensave profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontrates.*

* Ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomike, Liçensat profesionale duhet t'i paraqese operatori ekonomik qe ka marre persiper punimet per te cilat kerkohet Liçensa Profesionale.

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
<i>NP-1</i>	<i>Punime gërmimi në tokë.</i>	<i>Punime gërmim dheu</i>	<i>A</i>	<i>0-20 milion</i>
<i>NP-3</i>	<i>Rikonstruksion dhe mirëmbajtje gadinash civile e industriale, veshje fasada</i>	<i>Punime për rikonstruksionin e fasadës së objekteve, çatave, dyerë, dritare si dhe shtresave të dyshemesë</i>	<i>B</i>	<i>21-50 milion</i>
<i>NS-1</i>	<i>Punime për prishjen e ndërtimeve</i>	<i>Prishje suvaje, prishje çati si dhe heqje dyerë e dritare</i>	<i>A</i>	

NS-4	<i>Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me matëriale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese</i>	<i>Suva e brendëshme, suva fasade, lyerje, vendosje dyere e dritare, izolim solete si dhe veshje e dyshemeve te banesave</i>	A	0-20 milion
NS-8 c.	<i>Struktura Druri</i>	<i>Vendosja e dyereve te bendeshme</i>	A	0-20 milion
NS-14	<i>Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj</i>	<i>Ristrukturimi i linjave elektrike te brendëshme</i>	A	0-20 milion

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën ISO, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 (Sistem i Menaxhimit te Cilesise)
- ISO 14001:2015 (Sistem i Menaxhimit Mjedisor)
- ISO 45001:2018 (Sistem i Menaxhimi i sigurise dhe Shendetit ne pune)

Çertifikata e mësipërme duhet të jetë e vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Çertifikata e mësipërme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike ISO duhet plotësuar nga operatorët ekonomikë, sipas natyrës së punëve që marrin përsipër.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe bazuar në nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardete kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor, gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar ”.

- Për ISO 9001 - 2015; Kjo çertifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e

aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kyhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

- Per ISO 14001 – 2015: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015, standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit. Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritimit të përgjegjësive ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë. Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon një manaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

- Per ISO 45001:2018: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 45001:2018, standart ky që përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikën më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shendetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikën, procedurat dhe kontrollin e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **42 (dyzet e dy) punonjës** me kohe të plote pune për periudhën e **3 (tre) muajve të fundit Qershor-Korrik-Gusht** nga data e hapjes së ofertave, ku Stafit Teknik dhe punëtorët e kualifikuar të jenë me kohe të plote pune për periudhën e fundit **3 (tre) muajve** (*Qershor-Korrik-Gusht 2024*).

Per vertetimin e ketij kushti te paraqiten:

- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore/ose Tatimore
- Listpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar më sipër dhe të jenë të konfirmuara nga Dega Rajonale Tatimore ku është i regjistruar subjekti.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, nenit 77, të ligjit nr 162 datë 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik “ dhe nenit 39, Pika 6/ç, të VKM nr 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të deshmohen që kanë fuqi minimale puntore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor në përcaktimin e fuqisë puntore të nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përllogaritje të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit teknik të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr 216 Datë: 13.04.2023” Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemit të Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për Zërat e Punimeve në Ndërtim në këtë kontekst autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve për objektin e prokurimit orëve të punës (8 orë në ditë për çdo punonjës) afatit kohor të realizimit të kontratës si dhe shpërndarjes së punës. Në numrin e përcaktuar për fuqinë puntore janë përllogaritur stafi teknik dhe inxhinjerik si dhe stafi administrativ. Nga përllogaritja e orëve të punës për çdo zë pune rezulton se për kryerjen e punimeve sipas grafikut të punimeve duhen **42 (dyzet e dy) punonjës** me kohe të plote.

Nr.	Nr. An.	Përshkrimi i punimeve	Njesia	Sasia	Ore pune punetori	Ore totale	Ore pune makineri	Ore totale
						42,420.29		1,163.89
1	2.426/11	Prishje suvatim muri i brendshem	m2	616.78	0.93	573.6054		0
2	2.430/2	Prishje çatie ekzistuese me tjegulla	m2	2767.09	1.62	4482.6858		0
3	2.262/4	Shtrese betoni C 16/20	m3	129.06	8.6	1109.916	0.73	94.2138
4	2.219	Çati vendi e zakonshme me HD~8m,tjegulla marseljeze	m2	5051.5	2.3	11618.45	0.02	101.03
5	2.297/c	Tavan i varur plastik	m2	2151.73	2.1	4518.633		0
6	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m	m2	1536.95	2.18	3350.551	0.1	153.695
7	2.310/1	Suva brenda mur tulle h~4m me pomp, llaç perzier M 25	m2	2399.46	0.775	1859.5815	0.22	527.8812
8	2.404/1	Boje hidroplastike cilesi e larte	m2	7061.79	0.36	2542.2444		0
9	2.375/2a	Dritare d/alumini dyfi xh.	m2	216.68	2.2	476.696		0
10	2.383	F.V Dyer druri	m2	294.39	2	588.78		0
11	2.490/f	F.V Kasete plastike KE me 36 modular (vende)	cope	42	4.9	205.8		0
12	2.490/1	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A, dl=0.03A	cope	43.07	1.5	64.605		0
13	2.485/d	F.V priza shuko universal	cope	268.6	1	268.6		0
14	2.487/b	F.V kuti suport pllaket 4 modular	cope	272	0.25	68		0
15	480/5	Tub PVC fleksibel vetshuares dj=32m/m	ml	516	0.43	221.88		0
16	480/3	Tub PVC fleksibel vetshuares dj=25m/m	ml	2409	0.43	1035.87		0
17	480/2	Tub PVC fleksibel vetshuares dj=20m/m	ml	2180	0.43	937.4		0
18	2.481/1	F.V percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	ml	4936.9	0.04	197.476		0
19	2.481/2	F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2	ml	4776	0.04	191.04		0
20	2.481/3	F.V percjelles PV-500 Ø 4 mm2	ml	1747	0.04	69.88		0
21	2.481/4	F.V percjelles PV-500 Ø 6 mm2	ml	600.5	0.04	24.02		0
22	2.481/5	F.V percjelles PV-500 Ø 10 mm2	ml	1913	0.04	76.52		0
23	2.487	F.V Kutiderivacioni plastm	cope	190	0.33	62.7		0
24	2.464	F.V. Ndricules tip plafoniere ,me llampe fluoeshente 40w,	cope	210	1.2	252		0
25	2.209/a	Ulluk shkarkimi vertikal me PVC Ø 120	ml	290	0.545	158.05		0
26	2.212/a	Ulluk shkarkimi horizontal me PVC 33cm	ml	900	0.79	711		0
27	2.326	Veshje me pllake majolike	m2	172	3.7	636.4		0
28	2.267/a	Shtrese me pllaka grez porcelanato	m2	2133.39	1.66	3541.4274	0.07	149.3373
29	2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama	m2	52	1	52	0.05	2.6
30	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	107.16		0		0
31	2117	Kollona b/a monolite C 16/20 h ~ 4m	m3	40.92	31.22	1277.5224	2.65	108.438
32	2.93	Mure me tulla shamot h~4m	m3	19.79	24.5	484.855		0
33	2.300/1	Suva solete ~ 4 m, me drejtues, me pompe	m2	157	1.425	223.725	0.17	26.69
34	2.324a	Plintuse pllake grez	ml	1516	0.35	530.6		0
35	2.386/2	Dyer te blinduara	m2	1.7	4.574	7.7758		0

Totali ore pune punetori $42,420.29 / (8 \times 22 \times 6) = 40.17$

Totali ore pune punetori per makinerit $1,163.89 / (8 \times 22 \times 6) = 1.10$

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje 3 (tre) muajt e fundit tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit i parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruar me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar si drejtues Teknik në stafin e tij për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.4, stafin inxhinierik si më poshtë:

- 1 (Nje) **Inxhinier Ndërtimi**
- 1 (një) **Inxhinier Elektrik**

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv.
- **Inxhinieri Elektrik** është kërkuar duke ju referuar projekt–preventivit ku parashikohet rikonstruksioni i linjave elektrike te disa prej banesave, me qëllimin për realizimin me cilësi dhe kushte sipas standarteve.

b) Staf i mbështetës Operatori ekonomik duhet të ketë të disponojë dokumentacionin që verteton profesionin si : Dëshmi profesionale të punonjesve ose ekuivalent të tij/saj, , punonjësit e mëposhtëm me specialitetin si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë sipas pikës mesipërme (2.3.4) :

- 2 (dy) **Teknik i mesem Ndërtimi** (Diplome e shkolles mesme)
- 5 (pese) **Murator** (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 5 (pese) **Bojaxhi** (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 2 (dy) **Elektricitist** (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 3 (tre) **Pllakashtrues** (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 10 (dhjete) **Puntor i specializuar për ndërtim çatie**
- 5 (pese) **Puntor i thjeshtë**

* Në lidhje me këto pike operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë dokumentacionin që verteton profesionin si :

- Kontratat e punës individuale të vlefshme
- Për stafin e mesipërm, Dëshmia e kualifikimit/ certificate dhe/ose diploma e cila të jetë e leshuar nga Ministria e Financave ose të njihet nga Ministria e Punës Ceshtjeve Sociale të paraqitet certificate/diploma profesionale për secilin. Certificate / diplomat duhet të jenë të leshuara nga

institucione publike/private te licensuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.”, i ndryshuar. Kjo kerkese po ashtu eshte ne perputhje me vendimin nr. 441/2020, date 09.10.2020 te Komisionit te Prokurimit Publik. Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma te cilat nuk jane te licencuara sipas legjislacionit ne fuqi do te konsiderohen si dokumenta te rreme te cilat perbejne shkak per skualifikim dhe/ose perjashtimin e ketij kontraktori nga pjesemarrja ne prokurimet publike.

- Certificate te sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione te autorizuar nga /ish (IQT) e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise
- *Diplome nga institucionet e arsimit te mesem profesional(publik/privat) te akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne RSH”, kontrate pune te vlefshme dhe te figuroje ne listepagesa.*
- Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit te marredh enieve t punes	Nr.Amzes/ekuivalent diplomes / certificates profesionale	Institucioni/ Subjekti certifikues	Data e vlefshmerise se certifikates profesionale
----	--------------	------------	---	--	------------------------------------	--

Kriteri konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit te vetedeklarimit sipas shtojces 8 te DST.

Shenim: Referuar pikes 1, te nenit 26, te VKM nr.285, date 19.05.2021, **i ndryshuar**, ku parashikohet: “Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas percaktimit ne nenin 82, te LPP-se, dhe ne keto rregulla”, si dhe percaktimet e pikes 6, te ketij neni, ku parashikohet: “**Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” te pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njesuara me origjinalin**”.

Argumentim: Kerkesa e mesiperme eshte bazuar ne paragrafin 3 te pikës 4, te nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifkimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Numri është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Teknik i mesem Ndërtimi** referuar specifkimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit duke siguruar kështu kontrollin e cilësisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit.
- **Murator** referuar specifkimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve të nr. analizave 2.93, 2.331, 2.310/1.

- **Bojaxhi** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve në nr. e analizës 2.404/1
- **Elektriçist** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen e duhur të punimeve elektrike.
- **Pllakashtrues** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve në nr. e analizës 2.267/a, 2.326 dhe 2.324a.
- **Puntor i specializuar për ndërtim çatie** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen e duhur të punimeve të çatisë referuar zërave të analizës 2.219, 2.209/a, 2.212/a. .
- **Puntore te thjeshte** bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar nr. te analizave 2.426/1, 2.430/2, 2.262/4, 2.375/2a.

c) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, të pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi të lëshuar nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.4, punonjës me specialitetin si më poshtë:

- Minimuni **1 (një) person** që përmbush kriteret për të qenë **“Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”** nga kryqi i kuq ose organe te akredituar te njohur nga Republika e Shqiperise.
- Minimuni **1 (nje) persona** që përmbush kriteret për të qenë **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** lëshuar nga organe te akredituar te njohur nga Republika e Shqiperise.
- Minimuni **1 (një) person** që përmbush kriteret për të qenë **“Ekspert Zjarrfikës i pajisur me Licence**

I.2.A në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Per kete duhet te paraqitet Certificate/deshmi per ekspert zjarrfikes te lëshuar nga Ministria e Puneve te Brendeshme, diploma dhe kontrata noteriale e punes.”

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Në mbështetje të nenit 7 të Ligjit Nr:10 237, datë 18.02.2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë” ku citohet. “Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale nëndërmarrje/institucion.

d) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë dhe vetë Drejtuesi Teknik) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Librezë pune (përkatëse)
- b) CV EU format përkatëse
- c) Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- d) Diplomë

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), leshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë :

- Shofer Kamionash 3 (tre)
- Manovratore 2 (dy)

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar minimumi **2 (dy)** manovratore me DAP, dhe **3 (tre)** shofer kamionash me CAP , të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.4, **dhe për secilin të paraqiten:**

- a. Kontratë pune të vlefshme,
- b. Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,

Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin përkatës, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

-Pajisje hidraulike;

-Pasjisje elektrike;

Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin që verteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin (kontratë/autorizim). Operatori ekonomik të paraqesë katalogjet përkatëse për secilin nga produktet/mallrat e mësipërme. Gjithashtu O.E. të paraqesë deklarate garancie jo më pak se 1 vit nga momenti i marrjes në dorëzim.

- a) **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;**

Mjetet	Sasia	Pronësia
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 10	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinç min 6 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me kapacitet mbajtes 3.5 ton min – 5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me kapacitet mbajtes 2.5 ton min – 3 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobot Uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadroma me goma me kove para dhe mbrapa	2 copë	Pronësi ose me qera
Minifadrome	1 copë	Pronësi ose me qera
Depozitë uji 5000 litra	2 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere 0.3 – 0.5 m3	5 copë	Pronësi ose me qera

Makinerite dhe mjetet e larte permenduara jane te nevojshme per shkak se objekti i prokurimit ka te beje me riparim banesash dhe jane me vendodhje dhe distanca te ndryshme nga njera tjetra. Behet fjale në 5 (Pesë) njwsi Administrative me distanca tw ndryshme .

Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë ;

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet : a) Dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);

b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);

c) Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)

d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;

e) Liçencë transporti;

f) Çertifikatë transporti nga njësia vendore;

g) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, duhet të paraqitet : a) Kontrata e qerasë

b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);

c) Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)

d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;

e) Liçencë transporti (për transport mallrash për të tretë dhe me qera);

f) Çertifikatë transporti nga njësia vendore;

g) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë apo marrjen me qira të tyre (fatura tatimore blerje, akte ç'doganimi, kontrata noteriale për marrjen me qira)

- Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).

- Operatori ekonomik duhet te deklarojë vendodhjen e mjeteve, me qëllim verifikimi në çdo kohë prej Autoritetit Kontraktor deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës se makinerive.

- Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak s'kualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Teknik: Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar ne VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.”

Konkretisht:

- Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 10 ton u referohet analizave Nr. 2.262/4; 2.219; 2.297/c; 2.331; 2.310/1; 2.209/a; 2.326; 2.267/a; 2.197; 2.37/5b; 2.117; 2.93; 2.3000/1; 2.324a dhe 2.386/2.
- Kamion me vinc min 6 ton u referohet analizave Nr. 2.262/4; 2.219; 2.297/c; 2.331; 2.310/1; 2.209/a; 2.326; 2.267/a; 2.197; 2.37/5b; 2.117; 2.93; 2.3000/1; 2.324a dhe 2.386/2.
- Kamion me kapacitet mbajtes 3.5 ton min – 5 ton u referohet analizave Nr. 2.262/4; 2.219; 2.297/c; 2.331; 2.310/1; 2.209/a; 2.326; 2.267/a; 2.197; 2.37/5b; 2.117; 2.93; 2.3000/1; 2.324a dhe 2.386/2.
- Kamion me kapacitet mbajtes 2.5 ton min – 3 ton u referohet analizave Nr. 2.262/4; 2.219; 2.297/c; 2.331; 2.310/1; 2.209/a; 2.326; 2.267/a; 2.197; 2.37/5b; 2.117; 2.93; 2.3000/1; 2.324a dhe 2.386/2.
- Autobot Uji i referohet analizave Nr. 2.300/1; 2.117; 2.331 dhe 2.310/1.
- Fadroma me goma me kove para dhe mbrapa u referohet analizave Nr. 2.262/4 dhe 2.37/5b.
- Minifadrome u referohet analizave Nr. 2.262/4 dhe 2.37/5b.
- Depozitë uji 5000 litra i referohet analizave Nr. 2.300/1; 2.117; 2.331 dhe 2.310/1.
- Betoniere 0.3 – 0.5 m3 i referohet analizës Nr. 2.117.

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – jo më pak se 40 copë
- Jeleke – jo me pak se 40 copë
- Rripa sigurie – jo më pak se 30 copë

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.